

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 20, datë 27.04.2021 të Bordit të Administrimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall konkursin publik për Përgjegjës të Sektorit të Auditit, si më poshtë:

I. KANDIDATËT PËR PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË AUDITIT DUHET TË PLOTËSOJNË KËTO KRITERE:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike ose Juridike.
- b) Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e auditimit si auditues i brendshëm ose i jashtëm.
- c) Të ketë mbrojtur me dëshmi titullin “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

II. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË AUDITIT

Nuk mund të kandidojnë për Përgjegjës të Sektorit të Auditit, kandidatët që

- a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
- b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) Janë të dënuar me parë për vepra penale;
- d) Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.

III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar.
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **26.05.2021** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.